

MANUALI

PËR ANALIZIMIN E BUXHETIT NGA PERSPEKTIVA GJINORE





Autori: Marija Vukovic

"Ky publikimi është krijuar në kuadër të projektit "Rrjeti i Monitorimit të Buxhetimit Gjiner në Ballkanin Perëndimor dhe Republikën e Moldavisë" me financim të Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) dhe Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA). Qëndrimet e shprehura në këtë studim janë të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht qëndrimet e ADA apo SIDA."

Content

Mësimi 1

PËRKUFIZIMI I BUXHETIT DHE SISTEMIT TË
BUXHETIMIT

Mësimi 2

BUXHETIMI I PËRGJIGJSHËM GJINOR

Mësimi 3

MJETET PËR ANALIZIMIN NGA PERSPEKTIVA
GJINORE TË SHPENZIMEVE BUXHETORE

Mësimi 4

MJETET PËR ANALIZIMIN GJINOR TË TË
ARDHURAVE BUXHETORE

SHKURTESAT

- Organizatë e shoqërisë civile (OSHCs)
- Buxheti i Përgjegjshëm Gjnor (BPGJ)
- Menaxhimi i Financave Publike të Përgjigjshme Gjnore (MFPPGJ)
- Menaxhimi i Financave Publike (MFP)
- Sistemi Fiskal Global (SFG)
- Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OBZHE)
- Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN)
- Deklarata e Buxhetimit Gjnor (DBGJ)
- Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (KEDNG)



HYRJE: Për çfarë shërben ky udhëzues?

Ky udhëzues është rezultat i fazës së dytë të projektit "Rrjeti i Mbikëqyrësve të Buxhetimit Gjnor" (RRMBGJ) dhe ka për qëllim t'u shërbejë organizatave të shoqërisë civile (OSHC) të interesuara për buxhetimin e përgjegjshëm gjnor. Faza e parë dhe e dytë e projektit RRMBGJ ka për qëllim rritjen e interesit të OSHC-ve për përdorimin e BPGJ-së. Ai fokusohet tek analizimi i buxhetimit nga perspektiva gjnore si një mjet kyç për BPGJ-në dhe ofron një hyrje në bazat e BPGJ-së si një mjet për integrimin gjnor.

Në hyrjen e këtij udhëzuesi bëhet një prezantim i kësaj çështjeje, kryesisht në aspektin e njohurive elementare rreth barazisë gjnore, politikave gjnore dhe buxhetimit gjnor si pjesë e integritimit gjnor, si strategjia globale për arritjen e barazisë gjnore dhe fuqizimin e grave dhe vajzave ([Gender-mainstreaming-Strategy-for-achieving-gender-equality-and-empowerment-of-women-girls-en.pdf \(unwomen.org\)](#)). Integrimi gjnor përkufizohet si një kornizë konceptuale, si një metodologji dhe prezantim i praktikave të mira dhe nënkupton përfshirjen e perspektivës gjnore me qëllim transformimin e strukturës institucionale drejt barazisë gjnore. Në pjesën e tij të parë jepet një përkufizim i buxhetit dhe procedurës së miratimit të buxhetit. Në pjesën e dytë bëhet një prezantim i shkurtër i ciklit të menaxhimit të financave publike, jepet një përkufizim i buxhetimit të përgjegjshëm gjnor, çfarë është dhe çfarë do të thotë buxhetim i përgjegjshëm gjnor, si dhe renditen klasifikimet e buxhetit, formatet e buxhetit dhe mjetet më të rëndësishme buxhetore për BPGJ-në. Në pjesën e tretë të udhëzuesit jepet një përshkrim më i hollësishëm i mjeteve për analizimin nga perspektiva gjnore të shpenzimeve buxhetore. Aty ofrohen disa udhëzime bazë se si analizohet pjesa e shpenzimeve të buxhetit nga aspekti i barazisë gjnore. Prandaj, kjo pjesë e Udhëzuesit të BPGJ-së është një pjesë e domosdoshme e procesit të prezantimit të procesit të BPGJ-së. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet rëndësia e këtij ndryshimi, sepse vendosja e theksit të procesit dhe të trajnimit nënkupton më shumë hapje, më shumë fleksibilitet dhe një përfshirje më të madhe të aktorëve vendorë. Ndërkohë, pjesa e katërt ka për qëllim që të ndihmojë lexuesit të kuptojnë çështjet kryesore gjnore sa u përket tatimeve dhe të ardhurave publike, të kuptojnë se si lidhen të ardhurat publike me shpenzimet publike, të kuptojnë parimet që duhen pasur parasysh në analizimin e sistemeve tatimore nga perspektiva gjnore. Në këtë pjesë do të trajtohen të ardhurat publike dhe BPGJ-ja (të ardhurat publike

dhe shpenzimet publike si dy anë të së njëjtës monedhë), detyrimet që lidhen me tatimin nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut dhe disa shembuj të përzgjedhur se si duhet parë aspekti gjinor i tatimeve dhe strukturës tatimore. Në pjesën e fundit të udhëzuesit përmbledhen përfundimet dhe ofrohet edhe një listë kontrolli.

Ky udhëzues nuk mbron idenë se njohuritë profesionale mund të zëvendësohen me aftësi të fituara nga trajnimet apo seminarët, pavarësisht sa të mirëorganizuar mund të jenë ato. Me fjalë të tjera, edhe pse pjesëmarrësit duhet të kuptojnë thelbin dhe dinamikën e këtij procesi, ata duhet ta fusin BPGJ-në në procesin e tyre të punës së bashku me ekspertët. Është jashtëzakonisht e rëndësishme të theksohet kjo gjë, pikërisht ngaqë fusha e politikave gjinore duhet të mbështetet te njohuritë profesionale, në mënyrë që ajo të mund të afirmohet përmes autoritetit të njohurive dhe argumenteve të ekspertëve si në nivel lokal, ashtu edhe në atë kombëtar.




01

PËRKUFIZIMI I BUXHETIT DHE SISTEMIT TË BUXHETIMIT



Termi “buxhet” vjen nga fjala latine “bulge”, e cila do të thotë “çantë lëkure”, një çantë që mbahet zakonisht nga ministri i financave (që këtej vjen edhe fjala bugler). Buxheti përfaqëson një plan të sistemuar të të ardhurave dhe shpenzimeve shtetërore për një periudhë të caktuar kohore, zakonisht për një vit. Me sistemim nënkuptohet klasifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve sipas një metodologjie të caktuar (si për shembull SFG-ja si metodologji e FMN-së, metodologjia e OBZHE-së ose metodologji të tjera). Krahas të ardhurave dhe shpenzimeve, pjesë e buxhetit është edhe defiçiti/sufiçiti. Në rast defiçiti fiskal, buxheti përmban një plan për financimin e tij (plan për të marrë hua nga shteti, plan për shitje pronash dhe kapitalesh, plan për emetim parash, ose plan për konsolidimin e të ardhurave dhe shpenzimeve). Në rast sufiçiti, buxheti përmban një plan për ndarjen e fondeve të tepërta (mund të shlyejë borxhin publik para afatit, mund ta depozitojë tepërcën në bankat qendrore për periudhat kur del me defiçit, mund ta hedhë tepërcën në tregun financiar).

Procedura e buxhetimit është një proces që përbëhet nga disa faza të ndërlidhura dhe të kushtëzuara::



INë praktikë, **përgatitja e buxhetit përfshin**: iniciativën buxhetore, planifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe përgatitjen e projekt-buxhetit. **Iniciativa buxhetore** përbën aktivitetin e parë të përgatitjes së buxhetit. Iniciativa për hartimin e buxhetit ndërmerret më së shpeshti nga Ministria e Financave. Ajo përfaqëson një sërë udhëzimesh, pikëpamjesh dhe sugjerimesh lidhur me përpilimin, hartimin dhe miratimin e buxhetit, si dhe metodologjinë e planifikimit buxhetor dhe balancimin e të ardhurave dhe shpenzimeve. **Të ardhurat planifikohen** në bazë të tendencave të pritshme makroekonomike, ndryshimeve të planifikuara në sistemin tatimor, aktiviteteve të planifikuara për frenimin e ekonomisë informale, etj. **Në planifikimin e shpenzimeve**, gjithçka nis nga niveli aktual dhe ky nivel korrektohet në përputhje me: kuadrin e pritshëm makroekonomik, synimet dhe prioritetet e Qeverisë dhe për të shmangur çfarëdolloj deformimi, bëhen krahasime edhe me vende të tjera. Ministria e Financave, në përcaktimin e shpenzimeve negocion me ministri të tjera, sindikata etj. **Procedura e hartimit të buxhetit** bazohet në përgatitjen e projekt-buxheteve dhe propozimeve në lidhje me buxhetin. Organi përgjegjës për çështjet buxhetore e bën hartimin e projekt-buxhetit, duke iu drejtuar përfituesve të buxhetit që ata të paraqesin kërkesat dhe propozimet e tyre lidhur me qëllimin dhe përdorimin e fondeve. Pas mbledhjes dhe shqyrtimit të propozimeve të përfituesve të buxhetit, bëhet rakordimi i të ardhurave dhe shpenzimeve të planifikuara në buxhet. Pas harmonizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të planifikuara, Ministria e Financave ia dërgon projekt-buxhetin Qeverisë. Pas marrjes së projektbuxhetit, Qeveria e shqyrton dhe ia përcjell Kuvendit për miratim.

Projektbuxheti i paraqitur nga Qeveria i dërgohet Kuvendit për shqyrtim në organet parlamentare. Kjo fazë quhet **përcaktimi i buxhetit**. Në Kuvend funksionon një komision parlamentar që mbulon financat ose buxhetin. Ky komision parlamentar ka për detyrë të shqyrtojë dhe të analizojë projektbuxhetin para se ai t'u paraqitet deputetëve për vendim dhe miratim. Kur projektbuxheti "kalohet" nga komisioni parlamentar kompetent, ai u "vihet në dispozicion" deputetëve dhe u propozohet për miratim. Vendimmarrja e drejtpërdrejtë e parlamentit mbi buxhetin ka në thelb dy faza:

- 1** në fazën e parë, Kuvendi e diskuton buxhetin në parim dhe e miraton buxhetin në parim
- 2** në fazën e dytë, Kuvendi e diskuton buxhetin në detaje dhe merr vendim për buxhetin në detaje.

Vendimi i Kuvendit për buxhetin paraqet pjesën përfundimtare të përpilimit, hartimit dhe miratimit të buxhetit. Në praktikën buxhetore ekziston mundësia që buxheti të mos miratohet para fillimit të vitit për të cilin miratohet. Arsyet mund të jenë politike, ekonomike, sociale, juridike e të tjera. Në raste të tilla, për të siguruar funksionimin normal të shtetit dhe të organeve të tij, përdoret financimi i përkohshëm. Procedura e financimit të përkohshëm zhvillohet në përputhje me procedurën buxhetore të parashikuar me ligj.

Kur organi përfaqësues miraton buxhetin, fillon zbatimi i tij. Procesi i ekzekutimit të buxhetit rregullohet me akte nënligjore, të cilat rregullojnë mënyrën dhe procedurën e mbledhjes dhe shpenzimit të fondeve. Ekzekutimi i buxhetit përbëhet nga dy pjesë:

part 1 mbledhja e të ardhurave

part 2 shpërndarja e të ardhurave tek përfituesit dhe menaxherët e fondeve.

Në fund të vitit buxhetor, Qeveria është e detyruar që t'i dërgojë Kuvendit llogarinë përfundimtare të buxhetit. Kështu, Kuvendi, përmes procedurës parlamentare përkatëse, verifikon nëse fondet janë përdorur në përputhje me Ligjin për Buxhetin. Në llogarinë përfundimtare të buxhetit bëhen bashkë llogaritë përfundimtare të të gjithë përfituesve direkt dhe indirekt të buxhetit. Struktura e llogarisë përfundimtare është e ngjashme me strukturën e buxhetit. Llogaria përfundimtare përmban një pjesë të përgjithshme dhe një pjesë të veçantë, si dhe bilancin e gjendjes së shtetit.

Objekt i kontrollit buxhetor janë të gjitha fazat e procedurës buxhetore, veçanërisht ekzekutimi i buxhetit. Me fjalë të tjera, kontrolli buxhetor paraqet një sërë masash dhe aktiviteteve që kanë për qëllim që, përmes përdorimit të disa formave dhe metodave të posaçme, të kontrollojnë se si janë mbledhur dhe si janë shpërndarë fondet buxhetore. Format ose llojet e kontrolleve varen nga metoda e aplikuar, koha kur bëhet kontrolli, objekti i kontrollit dhe organi që ushtron kontrollin. Bazuar në kriteret e mësipërme, dallojmë këto forma kontrolli të ekzekutimit të buxhetit:



Kontrolli administrativ konsiston në kontrollin e një autoriteti më të ulët nga një autoritet më i lartë brendapërbrenda secilës ministri. Kontrolli kontabël dhe juridik kryhet nga Inspektimi Buxhetor, i cili organizohet si një organ i pavarur në kuadër të Ministrisë së Financave. Kontrolli politik kryhet nga Kuvendi në bazë të raportit të Kontrollit të Lartë të Shtetit – organ i pavarur nga Ministria e Financave.

Profili i sistemit buxhetor përcaktohet nga shkalla e centralizimit (decentralizimit) të të drejtave buxhetore, si dhe nga mënyra e zgjedhur e financimit të shpenzimeve publike, nëse shpenzimet mbulohen vetëm nga buxheti (financimi i shpenzimeve publike përmes buxhetit) apo nga burime të ndryshme (pra shpenzimet publike bëhen jo vetëm nga buxheti, por edhe me fondeve publike, kapitale). Pra, këto janë konceptet e ndryshme të fushës së buxhetit - buxheti qendror ose buxheti i qeverisë qendrore (të ardhurat dhe shpenzimet e autoriteteve më të larta), buxheti i konsoliduar (ku përfshihen edhe autoritetet provinciale dhe lokale) dhe buxheti kuazi-fiskal.



02

BUXHETIMI I PËRGJIGJSHËM GJINOR



2.1 Menaxhimi i Përgjigjshëm Gjinator i Financave Publike

Termi “menaxhim i financave publike” zakonisht u referohet elementeve të ciklit buxhetor vjetor, i cili zakonisht fokusohet te përgatitja e buxhetit, përcaktimi i buxhetit, ekzekutimi i buxhetit dhe kontrolli i buxhetit. Ka përgjithësisht një konsensus sa u përket objektivave të sistemeve të menaxhimit të financave publike. Ruajtja e disiplinës së përgjithshme fiskale mbetet objektivi i parë i sistemit të menaxhimit të financave publike që merret me ndërveprimin mes dy variablave: të ardhurave dhe shpenzimeve. Sistemi i menaxhimit të financave publike duhet të garantojë që burimet publike të mbeten të alokuara për prioritetet strategjike për të cilat është rënë dakord dhe të inkurajojë rishpërndarjen e burimeve nga prioritetet më të ulëta tek ato më të larta me qëllim garantimin e një shpërndarjeje efikase. Gjithashtu, këto sisteme duhet të garantojnë edhe operacione efikase duke arritur vlerën maksimale për paranë në ofrimin e shërbimeve.

Menaxhimi efikas i financave publike është baza e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe kontribuon në stabilitetin makroekonomik të vendit, në besimin e njerëzve te institucionet, duke sjellë përfitime si për qytetarët, ashtu edhe për ekonominë. Një menaxhim efikas bën që qytetarëve t’u ofrohen shërbime më të mira shëndetësore, sociale dhe shërbime të tjera publike, si dhe një standard më i lartë jetese. Buxheti, si pjesë e menaxhimit të financave publike, paraqet jo vetëm mjete ekonomike, por në të shprehen edhe prioritetet politike. Prandaj, buxhetet nuk janë asnjëse për sa i përket aspektit gjinator. Ato prekin gratë dhe burrat në mënyra të ndryshme dhe pasqyrojnë shpërndarjen e pabarabartë të pushtetit në shoqëri, siç janë dallimet ekonomike, kushtet e ndryshme të jetesës dhe rolet e ndryshme sociale. Buxhetimi gjinator tenton të vërë në dukje ndikimin që kanë buxhetet në barazinë gjinore dhe t’i kthejë ato në instrumente që kontribuojnë në rritjen e kësaj barazie. Buxhetimi gjinator përfshin të gjitha nivelet e ndarjes territoriale të pushtetit, si nivelin kombëtar, rajonal dhe atë lokal. Buxhetimi gjinator përfshin të gjitha fazat e procesit buxhetor dhe nënkupton një analizë dhe vlerësim të ristrukturimit të buxhetit duke treguar ndjeshmëri për aspektet gjinore.

Është e rëndësishme të theksohet se buxhetimi gjinator është pjesë integrale e përfshirjes së parimit të barazisë gjinore në të gjitha fushat (integrimi gjinator). Nëse duam të arrijmë përfshirjen e parimit të barazisë gjinore në praktikë, duhet të analizojmë buxhetet dhe politikat së bashku. Në mënyrë që të mbyllet hendeku midis politikave dhe financimit, buxhetimi dhe krijimi i politikave duhet të jenë të lidhura ngushtë. Prandaj, buxhetimi gjinator nuk kufizohet në politika në fusha të caktuara, por politikat në të gjitha fushat duhet t’i nënshtrohen buxhetimit gjinator. Ky është ndryshimi midis buxhetimit të përgjigjshëm gjinator dhe BPGJ-së në menaxhimin e financave publike. BPGJ-ja është një term më i gjerë dhe nuk duhet të barazohet me të parin. Përfshirja e perspektivës gjinore në të gjithë procesin e menaxhimit të financave publike. Kjo është një qasje gjithëpërfshirëse që integron perspektivën gjinore që nga planifikimi strategjik deri te hartimi i buxhetit dhe zbatimi i tij, si dhe auditimi dhe vlerësimi. Ajo pasqyron përmbushjen e plotë të kësaj qasjeje sipas përkufizimit të Këshillit të Evropës. Në parim, buxhetimi gjinator mund të integrohet në të gjitha fazat e ciklit të zakonshëm buxhetor.¹

Menaxhimi i financave publike të përgjigjshme gjinore (MFPPGJ) ka të bëjë me buxhetin për burrat dhe gratë, djemtë dhe vajzat. MFPPGJ-ja nuk kërkon një qasje të re ndaj buxhetimit, por një njohje të qartë të ekzistencës së elementeve gjinore të shoqëruara me përshtatjen dhe përforcimin e institucioneve dhe mjeteve ekzistuese. Megjithëse përpjekjet e MFPPGJ-së fokusohen kryesisht te nevojat e vajzave dhe grave, ato NUK duhet t’u hyjnë në pjesë nevojave për zhvillim të djemve dhe të burrave, si dhe nevojave të të rinjve dhe të moshuarve, personave me aftësi të kufizuara, etj.

1 file:///C:/Users/Marija/Downloads/gender%20budgeting-MH0319275ENN.pdf

MFPPGJ-ja bazohet tek të kuptuarit se vendimet e buxhetimit publik dhe sistemet e Menaxhimit të Financave Publike (MFP) ndikojnë në rezultatet ekonomike dhe sociale të burrave dhe grave, të rinjve dhe të moshuarve, personave me aftësi të kufizuara, etj. Përmirësimet në barazinë gjinore konsiderohen si pjesë përbërëse e objektivave të zhvillimit të një vendi dhe ato kërkojnë një ndarje adekuate buxhetore dhe një sistem të fortë MFP për t'u siguruar që buxhetet ndahen si duhet dhe zbatohen ashtu siç janë planifikuar. Për zbatimin e MFPPGJ-së duhet të kuptohet konteksti i pabarazive gjinore, si lindin ato, cilat janë shkaqet e tyre themelore strukturore dhe si mund të trajtohen manifestimet e tyre. Megjithatë, qeveritë zakonisht kanë një sërë instrumentesh përmes të cilave mund të avancohen politikat publike, një prej të cilave është edhe MFPPGJ-ja.

Futja e parimit të barazisë gjinore në procesin buxhetor nënkupton analizimin nga perspektiva gjinore të buxhetit dhe ristrukturimit të të ardhurave dhe shpenzimeve me qëllim përmirësimin e barazisë gjinore. Nuk ka ndonjë recetë unike për realizimin e buxhetimit gjinor, por ka disa procedura standarde analitike, hapa dhe instrumente teknike mbi të cilat mbështetet çdo proces i buxhetimit gjinor. Çdo proces i realizimit të buxhetimit gjinor përbëhet nga tre faza kryesore: analizimi i buxhetit nga perspektiva gjinore, ristrukturimi i buxhetit bazuar në analizën gjinore dhe integrimi i gjinisë si kategori analitike në proceset buxhetore.

Faza e parë, analizimi i buxhetit nga perspektiva gjinore, është një hap i domosdoshëm që tregon se buxheti ndikon ndryshe te gratë dhe ndryshe te burrat përmes ndarjes së shërbimeve, transfertave dhe përfitimeve që synohet të sjellë për qytetarët. Për të kryer këtë lloj analize, nevojiten të dhëna të ndara sipas gjinisë për përfituesit fundorë të programeve buxhetore, aktiviteteve programore dhe projekteve. Një analizë më e detajuar duhet të tregojë se sa i plotëson buxheti nevojat e përfituesve të ndryshëm, nëse plotësohen dhe sa plotësohen nevojat dhe rolet gjinore specifike të përfituesve, sfidat dhe barrierat me të cilat përballen ata që nuk kanë pasur akses në fonde, shkalla në të cilën buxheti reduktohet, përkeqësohet ose la të pandryshuar pabarazinë gjinore, hendekun mes politikave publike dhe vendimeve buxhetore dhe arsyet se pse buxheti duhet të marrë parasysh shkallën e ndryshme të pjesëmarrjes së grave dhe burrave.

Faza e dytë i referohet ristrukturimit të buxhetit bazuar në analizën gjinore dhe përfshin përcaktimin dhe propozimin e masave për uljen e pabarazisë. Faza e tretë synon integrimin e gjinisë si një kategori analitike në menaxhimin e financave publike. Kjo fazë është një proces kompleks dhe dinamik i përkthimit të politikave publike në një proces buxhetor që zhvillohet brenda dhe jashtë institucioneve dhe përfshin: shqyrtimin, analizën, kontrollet brenda institucioneve dhe kontrollet në terren, për të marrë parasysh nevojat reale dhe të ndryshueshme të grave dhe burrave, vajzave dhe një djemve.



2.2 Formatet e buxhetit dhe pikënisjet e BPGJ-së

Buxheti është një proces politik thelbësor, ku burimet e pakta ndahen për të përmbushur objektivat e dëshirueshme shoqërore. Një grup procesesh dhe procedurash që lidhin shpenzimin e fondeve me përmbushjen e objektivave të planifikuara. Përpjekjet për shpërndarjen e burimeve financiare përmes proceseve politike për t'u shërbyer qëllimeve të ndryshme të njeriut. Ekzistojnë disa kategori buxhetesh: buxhete ekonomike, administrative, funksionale dhe programore.

Kategoria e buxheteve ekonomike ka në fokus shpenzimet korrente dhe ato kapitale. Shpenzimet për mallra dhe shërbime që ka të ngjarë të zgjasin më pak se një vit, duke përfshirë të gjitha kostot operative të qeverisë (pagat e nëpunësve civilë, pagesat për furnizimin me ujë dhe energji të ndërtesave qeveritare, furnizimet e zyrave me materiale kancelarie), si dhe programet mbështetëse (subvencionet për bizneset dhe familjet, bursat për nxënësit dhe studentë, etj.). Shpenzimet kapitale janë shpenzimet për mallra dhe shërbime që përdoren për më shumë se një vit (si pajisje, mobilje, ndërtesa, tokë, infrastrukturë etj., por edhe për mirëmbajtjen e rrugëve dhe ndërtesave).

Kategoria e buxheteve administrative përfshin shpenzimet e klasifikuara sipas njësive qeveritare, agjencive dhe ministrive përgjegjëse. Kategoria e buxheteve funksionale përfshin shpenzimet e klasifikuara sipas funksioneve ose qëllimeve për të cilat shpenzohen. Këto kategori janë të standardizuara, si për shembull shërbimet administrative, arsimit, mbrojtja sociale dhe shëndetësia. Kategoria e buxheteve pragmatike grupon shpenzimet e bëra për të njëjtin qëllim në një program dhe grup aktiviteteve që lidhen me të.

Sa u përket formateve të buxheteve, dallojmë këto formate:

1. Buxheti me zëra sipas linjave të ndryshme shpesh quhet buxhet tradicional, ku hyrjet, të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten vetëm në kategorinë ekonomike dhe administrative, por jo në atë programatike. Ky format buxhetor jep shumë pak informacion mbi objektivat dhe synimet e qeverisë. Në të paraqitet thjesht çfarë është planifikuar të mblidhet nëpërmjet taksave dhe burimeve të tjera dhe çfarë do të shpenzohet për qëllime specifike (paga, subvencione, blerje mallrash dhe shërbimesh, etj.), si dhe në cilat ministri apo agjenci. Buxhetimi tradicional është kryesisht një proces planifikimi në rritje, ku buxheti i periudhës së mëparshme shërben si pikënisje për buxhetin e ardhshëm dhe të vetmet rregullime që bëhen, bëhen në bazë parashikimesh (p.sh. sipas parashikimeve për inflacionin, përlllogaritjen e të ardhurave). Ky buxhet shihet si buxheti që promovon status quo-në dhe shërben vetëm si ushtrim kontabiliteti.
2. Buxhetimi me bazë zero nisët nga supozimi se buxheti planifikohet çdo vit nga fillimi, duke e bërë këtë lloj buxhetimi formën më radikale të buxhetimit. Ky format nënkupton se të gjitha alokimet e buxhetit krijohen çdo vit nga e para dhe si të tilla nuk janë të realizueshme, prandaj ky lloj buxhetimi është më shumë një ideal - shpenzimet e qeverisë përcaktohen kryesisht nga kontratat ekzistuese dhe të drejtat e dhëna sipas ligjeve ekzistuese, kështu që nuk mund të shfuqizohen, për më tepër, qeveritë nuk kanë burime për ta rimenduar çdo shpenzim çdo vit. Megjithatë, është për t'u vlerësuar ideja se buxhetimi duhet të jetë më shumë se thjesht një "punë rutinë" dhe se kjo duhet të reflektohet pjesërisht në një formë më të avancuar buxhetimi (buxhetim i programuar dhe mbi bazë performance).

3. Buxhetimi mbi bazë programesh përfaqëson një klasifikim të buxhetit në programe, pastaj në aktivitete që janë baza e alokimeve buxhetore – fondi ndahet për programet dhe jo për artikujt ekonomikë (p.sh. për pagat).
4. Buxhetimi me bazë performancën ose buxhetimi me bazë rezultatet zakonisht përmban informacione mbi performancën (objektivat, treguesit kryesorë të performancës), lidh inputet (sasinë e parave të shpenzuara) me rezultatet (outputet dhe rezultatet) dhe, në këtë mënyrë, lejon monitorimin e arritjes së qëllimeve dhe objektivave – duke e bërë atë një mjet të rëndësishëm për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së qeverisë, duke përfshirë edhe promovimin e barazisë gjinore.


Kjo formë e avancuar e këtij formati buxhetor quhet edhe buxhetim me bazë performancën ose buxhetim me bazë rezultatet, ku buxheti shpërndahet duke u nisur nga performanca e pritshme. Ai lehtëson lidhjen e planifikimit strategjik me buxhetimin afatmesëm dhe buxhetimin vjetor dhe me menaxhimin e performancës.

Disa studime të fundit japin argumente për integrimin e qasjes së përgjegjshme gjinore në të gjitha fazat e ciklit buxhetor.² (Anwar, Downs dhe Davidson, 2016; Downes, von Trapp dhe Trapp dhe Nicol 2017; FMN 2017, Stotsky 2016). Një qasje e tillë nuk ka të bëjë me ndonjë metodë të re buxhetimi apo financim shtesë më vete, por më shumë me pranimin e qartë të nevojave të ndryshme financiare që vijnë për shkak të gjinisë dhe me përshtatjen e institucioneve dhe mjeteve ekzistuese buxhetore për t'i marrë parasysh këto nevoja të ndryshme. Pika kryesore këtu është përcaktimi i pikënisjes së ciklit buxhetor sa u përket çështjeve që lidhen me gjininë, duke përfshirë edhe mjetet për vlerësimin e politikave të ndryshme dhe garantimit që politikat e miratuara nga qeveria të financohen dhe të zbatohen në mënyrë efëçente dhe efikase (FMN, 2017).

² Këshilli i Evropës (2005), Raporti përfundimtar i Grupit të Specialistëve për Buxhetimin Gjinor (EG-S-GB), EG-S-GB (2004) RAP FIN; Divizioni i Barazisë, Drejtorja e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut, Këshilli i Evropës, Strasburg, (gjendet në http://www.mpsv.cz/files/clanky/12462/GenderBudgeting-report2005_En.pdf); Stotsky, J. (2016), 'Buxhetimi gjinor: konteksti fiskal dhe rezultatet aktuale', dokument pune i Fondit Monetar Ndërkombëtar, WP/16/149, Washington DC; Elborgh-Woytek. K. et al. (2013), 'Gratë, puna dhe ekonomia: përfitimet makroekonomike nga barazia gjinore', shënimi i diskutimit të stafit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, SDN/13/10 (<http://www.imf.org/external/pubs/ft/sdn/2013/sdn1310>); Downes, R., von Trapp, L. & Nikol S. 2017. Buxhetimi gjinor në vendet e OECD-së, Revista e OECD-së për Buxhetin, Vëllimi 2016/3 ([Buxhetimi gjinor-in-OECD-countries.pdf](#))



Figura 1: Harmonizimi i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor me procesin buxhetor në Serbi




2.3 Mjetet buxhetore për BPGJ-në

Qarkore për Kriteret e Projektbuxheteve të Propozuara – Qarkoret lidhur me kriteret që duhet të plotësojnë buxhetet e propozuara kanë për qëllim që të udhëzojnë agjencitë qeveritare se si t'i hartojnë projektbuxhetet e tyre për vitin e ardhshëm. Zakonisht në to jepen udhëzime për kufirin e buxhetit, prioritetet në ndarjen e buxhetit, si dhe udhëzime për hartimin dhe dorëzimin e buxhetit. Tavani buxhetor: Zakonisht i tregon secilës agjenci se cili është "tavani" i saj buxhetor për vitin e ardhshëm, d.m.th., deri në sa buxhet planifikon Komisioni i Planifikimit i Ministrisë së Financave t'i caktojë asaj agjencie. Prioritetet për ndarjen e buxhetit - në disa raste, qarkorja për kriteret e buxhetit përshkruan prioritetet e qeverisë që duhet të adresohen në ndarjet e buxhetit për vitin e ardhshëm. Udhëzime për hartimin dhe dorëzimin e buxhetit. Kjo qarkore jep edhe një sërë udhëzimesh të tjera për ministritë dhe për institucionet e tjera përkatëse që financohen nga buxheti qendror se si duhet ta motivojnë buxhetin e kërkuar. Zyrtarët e planifikimit dhe të buxhetit brenda ministrive dhe institucioneve më pas e përdorin këtë format për të hartuar projektbuxhetet e tyre. Këto projektbuxhete më pas inspektohen dhe negociohen me Komisionin e Planifikimit të Ministrisë së Financave përpara se të shkojnë tek subjektet e ardhshme miratuese, që zakonisht janë Kabineti dhe Parlamenti.

Shembuj nga rajoni: Federata e Bosnje-Hercegovinës

Fragment nga Udhëzimet Buxhetore të Federatës së Bosnje-Hercegovinës Nr. 1. 2022-2023

„... ju kujtojmë se Sistemi i Buxhetimit dhe Informimit për Menaxhimin e Performancës është përmirësuar me një modul mbi buxhetimin e përgjigjshëm gjinor. Sa u përket përfituesve të buxhetit, ata duhet të japin informacion në lidhje me aspektin gjinor të buxheteve që ata propozojnë. Përfituesit e buxhetit këshillohen të përfshijnë informacion mbi rezultatet e pritshme dhe mbi ndikimin e tij në barazinë gjinore ... si dhe mbi treguesit e performancës të ndara sipas gjinisë, dhe të bëjnë përshkrimin e numrit/përqindjes së pritshme të grave dhe burrave si përfituesit fundorë. Përveç kësaj, është e nevojshme të shqyrtohet zbatimi i nenit 8 të Ligjit për Barazi Gjinore të Bosnje-Hercegovinës sa i përket marrjes së masave të posaçme për grupet e përjashtuar në mënyrë disproporcionale, si për shembull gratë/vajzat...“



Deklarata e Buxhetimit Gjinor - Deklarata e buxhetimit gjinor (DBGJ) është një mjet kyç për punën e BPGJ-së, pasi ndihmon për të demonstruar përgjigjshmërinë gjinore të projektbuxhetit në momentin e prezantimit të tij në Parlament. Është një deklaratë ose raport nga qeveria se si trajtohen çështjet gjinore nga politikat buxhetore, shpenzimet dhe të ardhurat, dhe përmbledh ndikimet gjinore të buxhetit. Ajo gjithashtu mund të tregojë sistematikisht se si reflektohen angazhimet e politikave për barazi gjinore dhe përmbushja e nevojave të grave në ndarjen e buxhetit. Deklarata e buxhetimit gjinor është një dokument llogaridhënieje i hartuar nga qeveria për të paraqitur përpjekjet e saj drejt barazisë gjinore. Në të mund të prezantohen rezultatet e analizës së buxhetimit gjinor dhe të parashtrohen rekomandime për ndryshime të mëtejshme të objektivave, aktiviteteve dhe treguesve të matjes. Kështu, një DBGJ mund të përmbajë si në të kaluarën ashtu edhe në të ardhmen implikimet e buxheteve në adresimin e çështjeve të pabarazisë gjinore. Forma dhe përmbajtja e një DBGJ-je janë tregues të mirë të potencialit transformues të aktiviteteve të BPGJ-së: p.sh., një DBGJ me tregues të kufizuar gjinor të proceseve të numërimit teknokratik nuk është shumë premtues, ndërsa një DBGJ që bën një përshkrim të plotë të sfidave kryesore ndaj pabarazive dhe mënyrave se si mund të kapërcehen ato me anë të politikave dhe buxheteve do të hapte shtigje transformimi më të vlefshme.

Çdo qeveri mund të nxjerrë një deklaratë për BPGJ-në duke përdorur një ose më shumë nga mjetet e mësipërme për të analizuar programet dhe buxhetet e saj dhe për të përmbledhur implikimet e tyre me një numër treguesish kyç. Kërkon një shkallë të lartë koordinimi në të gjithë sektorin publik. Në kushte ideale, Deklarata e Buxhetit Gjnor përfshin informacion nga secili sektor.

Shembuj të Deklaratave të Buxhetimit Gjnor – Shqipëri

Çdo vit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë përgatit një Shtojcë të Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjnor për secilën nga fazat kryesore të procesit dhe e përfshin atë në dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm. Në këtë shtojcë ofrohen të dhëna të përgjithshme për statusin e BPGJ-së, si dhe një listë shteruese e Ministrive të Linjës dhe institucioneve të tjera të qeverisë qendrore që e kanë përfshirë efektisht BPGJ-në në dokumentet e tyre të PBA-së, duke specifikuar edhe nivelin e krijimit të programit buxhetor, si dhe kostot lidhur me aktivitetet për barazinë gjnore. Shembull:

<http://www.financa.gov.al/programi-buxhetor-afatmesem-2020-2022-faza-iii/>

Për analizën e BPGJ-së duhet të njihen mjetet e analizës së buxhetit gjnor, si në lidhje me shpenzimet publike ashtu edhe me të ardhurat publike. Është veçanërisht e rëndësishme të kuptohet se cilat mjete të BPGJ-së përdoren në faza të ndryshme të procesit buxhetor.

Figura 2: Mjetet për analizimin e PBGJ-së



Tipologjia e OEBZH-së e mjeteve të përzgjedhura të PBGJ-së:

Mjetet paraprake (ex-ante) GRB janë: Vlerësimi nga perspektiva gjinore paraprake (ex ante), analiza bazë e buxhetit nga perspektiva gjinore, vlerësimi i nevojave gjinore, qasjet paralele të buxhetimit gjinor, përcaktimi i performancës nga perspektiva gjinore, perspektiva gjinore në shpërndarjen e burimeve dhe analiza e incidencës buxhetore nga perspektiva gjinore

Vlerësimi paraprak (ex-ante) i ndikimit të buxhetit nga perspektiva gjinore është vlerësimi i një mase të vetme buxhetore para se ajo masë të përfshihet në buxhet duke parë me një interes të veçantë se si ndikon zbatimi i asaj mase në jetën e grave dhe të burrave.

Analiza bazë e buxhetit nga perspektiva gjinore është analiza që kryhet në mënyrë periodike për të vlerësuar se si kontribuon ndarja e shpenzimeve dhe të ardhurave qeveritare te barazia gjinore. Kjo analizë kryhet përpara procesit të hartimit të buxhetit për të parë se si ndikon ndarja e shpenzimeve dhe të ardhurave qeveritare në barazinë gjinore. Informacioni nga kjo analizë mund të përdoret për të ndihmuar në drejtimin e vendimeve të mëtejshme për shpërndarjen e burimeve dhe për t'u siguruar që projekt-propozimi i buxhetit të adresojë boshllëqet e barazisë gjinore aty ku ka të tilla. Një analizë e tillë zakonisht kryhet nga autoriteti buxhetor qendror (ose nën autoritetin e tij).

Qasjet paralele të buxhetimit gjinor: Perspektiva gjinore në përcaktimin e performancës, perspektiva gjinore në shpërndarjen e burimeve, analiza e incidencës buxhetore nga perspektiva gjinore dhe ndjekja e shpenzimeve të bëra për barazinë gjinore.

Kërkesat për përcaktimin e performancës nga perspektiva gjinore sipas të cilave një përqindje minimale e objektivave të performancës lidhur me buxhetin të lidhet me politikat e përgjegjshme ndaj gjinisë.

Perspektiva gjinore në kriteret e shpërndarjes së burimeve sipas të cilave një pjesë minimale e burimeve të përgjithshme të buxhetuara duhet t'u caktohet politikave me ndjeshmëri gjinore.

Analiza e incidencës së buxhetit lidhur me gjininë buxheti vjetor shoqërohet me një vlerësim zyrtar, të kryer nga autoriteti qendror i buxhetit (ose nën autoritetin e tij) të ndikimit që ka në përgjithësi buxheti në promovimin e barazisë gjinore, duke përfshirë edhe analizimin e masave specifike të politikave të ndryshme (si për të ardhurat, ashtu edhe për shpenzimet) sipas gjinisë.

Mjetet e BPGJ-së pas ngjarjes (ex-post) janë: Vlerësimi i ndikimit gjinor pas ngjarjes (ex-post), auditimi i buxhetit nga perspektiva gjinore, perspektiva gjinore në rishikimin e shpenzimeve.

Vlerësimi pas ngjarjes (ex post) i ndikimit të buxhetit nga perspektiva gjinore që ka të bëjë me vlerësimin e masave buxhetore një nga një, pas futjes/zbatimit të tyre, veçanërisht për të parë se sa kanë ndikuar këto masa në barazinë gjinore.

Auditimi i buxhetit nga perspektiva gjinore - analizë e pavarur, objektive, e kryer nga një autoritet kompetent i ndryshëm nga autoriteti qendror i buxhetit për të parë se sa është promovuar dhe sa është arritur efektivisht barazia gjinore përmes politikave të përcaktuara në buxhetin vjetor.

Perspektiva gjinore në rishikimin e shpenzimeve që ka të bëjë me përfshirjen e aspektit gjinor në rishikimin e shpenzimeve në shkallë kombëtare, si një dimension i veçantë i analizës.


Po të analizojmë mjetet e përdorura nga vendet e OEBZH-së që kanë aplikuar buxhetimin gjinor, dallojmë tre kategori të gjera sistemesh të buxhetimit gjinor

- 1** Shpërndarja e burimeve duke qenë të mirinformuar për aspektet gjinore, që do të thotë se vendimet për politikën që ndiqen dhe ndarja e fondeve bëhet duke marrë për bazë vlerësimet gjinore
- 2** Buxhete të bazuara në vlerësimet gjinore që do të thotë se buxheti vlerësohet nga perspektiva gjinore dhe
- 3** Buxhetimi i bazuar në nevojat gjinore që do të thotë se vlerësimi i nevojave të gjinive të ndryshme është pjesë e procesit të hartimit të buxhetit.



03

MJETET PËR ANALIZIMIN NGA PERSPEKTIVA GJINORE TË SHPENZIMEVE BUXHETORE



3.1 Monitorimi i shpenzimeve në funksion të barazisë gjinore

Sondazhi i monitorimit të shpenzimeve në funksion të barazisë gjinore kërkon të vlerësojë nëse shpenzimet përdoren për qëllimin për të cilin janë buxhetuar. Vlerësimi i politikave me ndjeshmëri gjinore ka të bëjë me ndikimin real ose potencial që mund të kenë politikat, programet politike dhe strategjitë në marrëdhëniet gjinore. Duke u nisur me supozimin se vendimet politike për shpërndarjen e burimeve pasqyrojnë gjithmonë marrëdhëniet gjinore, analizohen efektet e tyre specifike sipas gjinisë dhe kërkohen përgjigjet për këto pyetje:³

1 A përfundojnë fondet publike dhe burimet materiale aty ku supozohet të shkojnë ?

Kjo pyetje ka të bëjë me flukset reale të fondeve publike në programe ose sektorë të buxhetit dhe ka për qëllim të vlerësojë se sa kanë arritur fondet publike tek ofruesit e shërbimeve.

2 Pse kanë devijuar fondet ?

Nëse vlera e fondeve të alokuara për një program apo zë të caktuar buxhetor ndryshon nga vlera e fondeve të marra nga një ofrues i caktuar shërbimi, kemi të bëjmë me një rrjedhje parash. Pyetja e dytë shërben si një instrument analitik për të kuptuar pse ndodh kjo rrjedhje fondesh. Praktikisht, pse disa shkolla marrin më shumë para publike se të tjerat. Ky instrument përdoret nga agjencitë donatore për të monitoruar se si shpenzohen paratë publike. Këtë instrument mund ta përdorin edhe OSHC-të për të monitoruar shpenzimet publike për të rritur llogaridhënien e autoriteteve vendore në raport me kërkesat e qytetarëve. Për shembull, në Novi Sad, është ngritur një rrjet OSHC-sh, i cili merret me monitorimin e shpenzimeve publike të buxhetit të bashkisë dhe sheh nëse përmbushen nevojat e qytetarëve (Projekti “Buxheti i përshtatur për gratë: Drejt arritjes së barazisë gjinore në Novi Sad).

Tabela 1: Përqindja e programeve buxhetore të përgjigjshme gjinore në buxhetin total për vitet 2018, 2019 dhe 2020.

Viti	Buxheti (gjithsej)	Shuma e alokuar për programet buxhetore të përgjigjshme gjinore	% e buxhetit (gjithsej)
2020	29.130.251.112,85	3.117.398.535,00	10,70%
2019	25.963.389.927,00	2.693.380.910,00	10,37%
2018	24.487.953.296,04	2.505.696.124,00	10,23%

Burimi: Vendimi për Buxhetin e Bashkisë së Novi Sadit për vitet 2018, 2019 dhe 2020.

3 Buxhetimi për t'i dhënë fund pabarazive gjinore në sektorin e arsimit | Konsorciumi për Barazinë Gjinore, Siguri dhe të Drejtat e Njeriut (genderandsecurity.org)

Në projektin e sipërpërmendur është analizuar totali i shpenzimeve për programet buxhetore me ndjeshmëri gjinore për tre vjet. Nga tabela mund të dilet në përfundimin se përqindja e alokuar për programet me ndjeshmëri gjinore ka një rritje të lehtë nga viti në vit.

Gjurmimi ose monitorimi i shpenzimeve bën një krahasim të shpenzimeve faktike me shpenzimet e planifikuara në buxhet. Ky proces ndjek ndarjet e buxhetit nga qeveria qendrore për ministritë dhe për autoritetet vendore dhe tregon se si është mbështetur me disbursime ofrimi i shërbimeve publike. Të dhënat për shpenzimet duhet të plotësohen me informacion se çfarë bëhet me disbursimin e burimeve dhe sa u përgjigjen shpenzimet prioriteteve dhe nevojave të njerëzve. Këtu mund të përfshihen analiza sasiore dhe/ose cilësore të ofrimit të shërbimit bazuar në vlerësimet e cilësisë, aksesit dhe kostos së shërbimeve dhe në bazë të anketave të përfituesve. Strukturat e forta qeverisëse dhe transparencja e të dhënave janë gjithashtu të rëndësishme për të marrë masa dhe për të korriguar shpërdorimin e fondeve publike, kur identifikohen raste të tilla përmes gjurmimit efektiv të burimeve.

Monitorimi i shpenzimeve në funksion të barazisë gjinore njihet edhe si “etiketimi gjinor i buxhetit” dhe ndihmon për vlerësimin sasior të flukseve financiare dedikuara kësaj fushe.

Për të kuptuar se sa kanë ndikuar shpenzimet publike në barazinë gjinore, gjurmimi i shpenzimeve fokusohet jo vetëm në politikat buxhetore të etiketuara në mënyrë eksplicite si të tilla (shembuj të tillë mund të jenë shpenzimet e alokuara për strukturën kombëtare gjinore, si për një Ministri/Agjenci për Barazinë Gjinore, ose shpenzimet e alokuara për trajtimin e dhunës me bazë gjinore) por edhe për politikat që i ofrohen publikut të gjerë, por që synojnë një gjini specifike (për shembull, projektet që fokusohen te decentralizimi dhe qeverisja vendore që kanë si objektiv specifik rritjen e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje në nivel lokal).

Shpenzime që promovojnë barazinë gjinore - Programe specifike të mundësive të barabarta sipas gjinisë (shpenzimet publike që fokusohen te leja e paguar e lindjes, subvencionimi i kujdesit për fëmijët për t'u dhënë mundësi grave të punojnë, programe të krijuara kryesisht për parandalimin e dhunës me bazë gjinore ose për marrjen e mesave ndaj saj, programet për edukimin dhe mobilizimin e burrave dhe djemve që ata të ngrihen kundër dhunës me bazë gjinore në komunitetet e tyre).

Shpenzimet me ndikime të pritshme gjinore – Shërbimet e përgjithshme publike të synuara ose të përdorura specifikuara nga njëra gjini (programet për mbështetjen e sipërmarrjeve të reja të teknologjisë së lartë me iniciativa specifike për mbështetjen e grave sipërmarrëse në fushën e teknologjisë, projektet e investimit për ndërtimin e një linje të re metroje me qëllim përmirësimin e përdorimit të sistemit të transportit nga gratë duke siguruar ndriçim të sigurt në rrugë dhe në afërsi të stacioneve).

Shërbimet e përgjithshme publike që funksionojnë pa ndonjë fokus të veçantë të barazia gjinore (programet për mbështetjen e aksesit të fermerëve vendas në mikrokredi për të blerë inpute bujqësore si pesticide ose plehra që nuk adresojnë paragjykimet gjinore sa i përket aksesit dhe inputeve bujqësore, programet që synojnë papunësinë e të rinjve por që nuk adresojnë marxhualizimin e djemve emigrantë).

Vendet me sisteme të forta klasifikimi buxhetor mund të përfitojnë nga një sistem i tillë për të gjurmuar shpenzimet buxhetore gjatë gjithë ciklit të hartimit, ekzekutimit dhe raportimit të buxhetit. Përfshirja e klasifikimit në planin kontabël të qeverisë (klasifikimi kontabël) siguron që çdo transaksion të mund të paraqitet jo vetëm në projektbuxhetin vjetor, por edhe të raportohet në përputhje me cilindo nga klasifikimet e përdorura (administrative, ekonomike, funksionale, programore) në raportet buxhetore të qeverisë dhe në raportet vjetore financiare. Nëse kjo bëhet në nivel zërash buxhetorë ose në nivel kodesh programatike, ato zëra buxhetorë ose

kodet e programeve mund të “etiketohen” për të kuptuar përgjithësisht më mirë shpenzimet në funksion të barazisë gjinore. Të gjithë zërat e etiketuar duhet të monitorohen nga Ministria e Financave për t’u siguruar që monitorimi i këtyre shpenzimeve të jetë pjesë e procesit buxhetor dhe jo një mekanizëm i veçantë institucional.

Mjetet dhe metodat monitoruese për identifikimin e shpenzimeve që janë të lidhura direkt ose indirekt me iniciativat e BPGJ-së brenda buxhetit. Mjetet që përdoren për monitorimin e shpenzimeve mund të përshtaten që të përfshijnë edhe elementë specifike që mundësojnë një gjurmim më të lehtë të shpenzimeve që lidhen me gjininë.

Është më e lehtë kur përdoren buxhete në bazë programesh ose buxhete me bazë performancën, por jo e pamundur edhe kur përdoret buxhetimi me zëra ose buxhetimi që nis nga zero.

Shembull nga Shqipëria

Qëllimi i Sistemit të Integruar Shqiptar të Informacionit të Menaxhimit Financiar (SSHIMF) është maksimizimi i efikasitetit dhe transparencës në planifikimin, ekzekutimin dhe raportimin e buxhetit.

Prioritetet kryesore të SSHIMF janë:

- Lidhja e planifikimit strategjik me buxhetimin
- Përmirësimi i procesit të planifikimit afatmesëm dhe përgatitjes së buxhetit
- Forcimi i buxhetimit me bazë programet dhe performancën
- Lehtësimi i përfshirjes së buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në Rishikimin e Buxhetit Afatmesëm, duke gjurmuar në mënyrë specifike Treguesit Kryesor të Performancës (TKP) dhe rezultatet gjinore.

SISIP është Sistemi Informativ i Sistemit të Integruar të Planifikimit që ofron mundësinë për të gjurmuar treguesit gjinorë të përfshirë në dokumentet strategjike/politike.

3.2 Analiza e incidencës së shpenzimeve publike nga perspektiva gjinore

Mungesa e informacioneve të ndara sipas gjinisë për lokalizimin dhe përdorimin e shërbimeve publike rrjedh nga fakti se në buxhet nuk specifikohen përfituesit e mundshëm. Analiza e incidencës së shpenzimeve publike të ndara sipas gjinisë tenton ta korigjojë këtë, duke shqyrtuar se cila pjesë e shpenzimeve shtetërore, në kuadër të një programi të caktuar, shkon në dobi të burrave dhe cila pjesë shkon në dobi të grave. Ky instrument mat shpërndarjen e burimeve buxhetore mes grave dhe burrave, vajzave dhe djemve, duke vlerësuar koston për njësi të shërbimit, duke llogaritur se sa e përdor atë shërbim secili grup. Ky instrument përfshin dy hapa. Së pari, llogariten ose vlerësohen kostot për njësi për një program të caktuar qeveritar. Pastaj kostot e nxjerra rillogariten në raport me numrin e përfituesve potencialë të programit të caktuar. Bazuar në sa më sipër, mund të llogaritet se sa para i alokon shteti secilit grup. Për shembull, në arsimin fillor, përdorimi i shpenzimeve publike për vajzat është vlera e shpenzimeve publike për arsimin fillor shumëzuar me raportin e vajzave të regjistruara në shkollën fillore me numrin e përgjithshëm të regjistrimeve në shkollën fillore. Po kështu, analiza mund të bëhet edhe në fushën e shërbimeve shëndetësore..

Pyetja kryesore është: Sa fonde i alokon buxheti i shtetit kujt? Ky mjet sasior mund të përdoret për të vlerësuar shpërndarjen e pagesave direkte (përfitimet financiare dhe transfertat) ose shërbimet publike të ofruara.⁴

Për të kryer këtë lloj analize kërkohen të dhëna sasiore për përfituesit (p.sh. numri i individëve sipas gjinisë që përdorin ose që konsumojnë shërbime publike specifike ose që marrin transferta financiare) dhe kostoja për njësi e ofrimit të shërbimeve publike. Llogaritja e incidencës së shpenzimeve publike të një shërbimi të caktuar mund të llogaritet duke shumëzuar koston për njësi të ofrimit të një shërbimi të caktuar me numrin e njësive të përdorura ose të konsumuara nga gratë dhe burrat (ose nga vajzat dhe djemtë).

Ashtu si në rastin e instrumenteve të tjera, është e rëndësishme të theksohet se ndarja e thjeshtë burra-gra është vetëm pika fillestare dhe mund të rezultojë të jetë shumë e përgjithshme, pasi mund të fshehë shumë dallime mes grave dhe burrave. Pra, është e rëndësishme që sa herë që është e mundur, të përdoren grupe të dhënash ndërsektoriale. Kështu, hapi i fundit i kësaj analize përfshin grumbullimin e individëve të familjeve në nëngrupe në mënyrë që të mund të vlerësohet se si shpërndahen shpenzimet publike në grupe të ndryshme grash dhe burrash. Variabli më i zakonshëm që përdoret, ndër të tjera, për formimin e këtyre grupeve janë të ardhurat. Analiza të tjera ndërsektoriale me rëndësi mund të përfshijnë përkatësinë etnike, moshën dhe vendndodhjen gjeografike (p.sh. urbane/rurale).⁵

Tabela 2: Shembull i analizës së incidencës së shpenzimeve të ndara sipas gjinisë të politikave aktive të tregut të punës në Republikën e Serbisë - hapi i parë i analizës së incidencës së shpenzimeve publike nga perspektiva gjinore

Masat e kërkimit aktiv të punës	Pjesëmarrësit	Gra	Gra si %	Burra	Burra si %
Trajnime për kërkim aktiv të punës	35962	20.085	55,85%	15.877	44,15%
Trajnime për efikasitet	2823	2.111	74,78%	712	25,22%
Trajnim për zhvillimin e aftësive të sipërmarrjes	13686	6.266	45,78%	7.420	54,22%
Trajnim për tregun e punës	63	34	53,97%	29	46,03%
Trajnim me kërkesë të punëdhënësve për personat e papunë	708	353	54,98%	352	45,02%

Burimi: Raport pune, f. 18-24, [ZVEŠTAJ O RADU NSZ ZA 2021.pdf](#)

4 Hadžiahmetović, A., Đurić-Kuzmanović, T., Klatzer, E. & Risteska M. 2013. Buxhetimi i Përgjigjshëm Gjinor, UN Women, f. 163.

5 Pika, fq.164-166.

Si hap i parë llogaritet pjesëmarrja e grave dhe burrave në numrin total të pjesëmarrësve në proceset e trajnimeve në tregun e punës.

Tabela 3: Shembull i analizës së incidencës së shpenzimeve nga perspektiva gjinore të politikave aktive të tregut të punës në Republikën e Serbisë - hapi i dytë i analizës së incidencës së shpenzimeve publike nga perspektiva gjinore

Trajnim për kërkim aktiv të punës	Kostoja për pjesëmarrës (në RSD) (në 1000 dinarë serbë)	Gra	Burra	RSD të shpenzuara për gratë (në 1000 dinarë serbë)	RSD të shpenzuara për burrat (në 1000 dinarë serbë)
Trajnimi për efikasitet	2.264.614	20.085	15.877	1.264.787	999.827
Trajnim për zhvillimin e aftësive të sipërmarrjes	377.435	2.111	712	282.246	95.189
Trajnim për tregun e punës	1.132.307	6.266	7.420	518.370	613.937
Trajnim me kërkesë të punëdhënësve për të papunët	15.975	34	29	8.622	7.353
Trajnim për kërkim aktiv të punës	31.950	353	352	17.566	14.384

Burimi: Raport pune, fq.18-24, [ZVEŠTAJ O RADU NSZ ZA 2021.pdf](#)

Si hap i dytë në analizën e masave, për secilin program që është ofruar në tregun e punës, llogaritet shpenzimi total në dinarë për gratë dhe për burrat.

Pavarësisht se çdo qeveri duhet të vlerësojë shërbimet që ofron dhe të identifikojë se kush i përdor ato, kjo detyrë është pothuajse e pamundur në shumë vende. Për llogaritjen e këtyre shpenzimeve, është e nevojshme të kemi të dhëna të sakta për përdorimin e parasë publike dhe për shpërndarjen e saj, të dhëna që nuk janë gjithmonë të disponueshme në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal. Për shembull, ato mund të jenë në formën e të dhënave administrative, si dosje apo të dhëna shkollore dhe shëndetësore që nuk janë gjithmonë të sistemuara.

3.3 Vlerësimet e përfituesve nga perspektiva gjinore

Vlerësimet e përfituesve të ndara sipas gjinisë bëjnë të mundur që të dëgjohet zëri i qytetarëve. Këto vlerësime përdoren për të përcaktuar pikëpamjet e grave dhe të burrave nëse modelet e shpenzimeve qeveritare dhe programet dhe shërbimet e lidhura me to janë në përputhje me prioritetet e qytetarëve dhe nëse shërbime të caktuara ofrohen si duhet. Domethënë, prioritetet politike nuk përkojnë automatikisht me nevojat e grupeve të ndryshme shoqërore. Burrat dhe gratë kanë pjesërisht interesa dhe nevoja të ndryshme dhe përfitime të ndryshme nga shërbimet e qeverisë. Vlerësimet e përfituesve të ndara sipas gjinisë janë një instrument që duhet të ndihmojë në përcaktimin e prioriteteve të grupeve të ndryshme sociale në aspektin e dobisë publike, për të parë se sa të kënaqura janë këto grupe me mundësitë që u ofrohen aktualisht dhe prioritetet e kujt do të përmbushen nga masa të caktuara të planifikuara, dhe cilat jo.

Përfitimet reale dhe potenciale të politikës së shpenzimeve publike shqyrtohen duke parë se si do ta ndanin buxhetin grupe të caktuara qytetarësh nëse do të ishin në vendin e Ministrit të Financave. Përgjigjet e tyre analizohen duke pasur parasysh edhe se si i plotëson politika buxhetore aktuale e qeverisë interesat e burrave dhe të grave, vajzave dhe djemve.

Pyetjet për të cilat ky mjet ofron përgjigje janë:

Si i adresojnë investimet publike në infrastrukturë dhe në ofrimin e shërbimeve publike nevojat dhe prioritetet e ndryshme të grave dhe të burrave



Vlerësimet e përfituesve të ndara sipas gjinisë janë një mjet që shërben për të mbledhur vlerësimet e përfituesve fundorë për të parë se sa plotësohen nevojat e tyre nga cilësia aktuale e shërbimeve publike. Kjo teknikë kërkimore përdoret për të pyetur përfituesit fundorë realë ose potencialë nëse politika e shpenzimeve publike përputhet me prioritetet e tyre.

Të dhënat për këtë analizë mund të merren nga burime sasiore (sondazhe të opinionit publik, sondazhe të qëndrimit dhe perceptimit, dhe sondazhe të tjera të ngjashme) dhe nga burime cilësore (metodat e vlerësimit me pjesëmarrje, diskutimet në fokus grupe, vëzhgimi i pjesëmarrësve). Një kombinim i metodave cilësore dhe sasiore të vlerësimit të përfituesve është intervista. Me metodat e sipërpërmendura, është shumë e rëndësishme që vlerësimet e mbledhura të përfituesve të klasifikohen sipas gjinisë dhe, nëse është e mundur, sipas kriterëve të tjera në varësi të qëllimit të anketës (p.sh., sipas moshës, shtresës, gjeografisë, pra nga zonat urbane ose rurale...)⁶

Zgjedhja e metodës së vlerësimit varet nga burimet në dispozicion, nga pyetja nëse është përfaqësimi statistikor si tregues sasiore ai që është më i rëndësishëm apo elementet pjesëmarrëse dhe informacionet e një natyre cilësore. Është e rëndësishme të theksohet se mjetet cilësore (për shembull, anketat) mund të çojnë në rezultate përfaqësuese statistikiisht, por kjo metodë nuk lejon diskutime apo të mësuarin social. Nga ana tjetër, mjetet cilësore (p.sh., diskutimet dhe vlerësimet me pjesëmarrjen e pjesëmarrësve) nënkuptojnë një proces mësimor interaktiv, por nuk çojnë në rezultate statistikiisht domethënëse. Prandaj, skenari ideal është një kombinim i rezultateve cilësore dhe sasiore.

6 Hadžiahmetović, A., Đurić-Kuzmanović, T., Klatzer, E. & Risteska M. 2013. Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjitor, UN Women, f. 167-168.



Metoda e vlerësimit të përfituesve të ndara sipas gjinisë mund të përdoret edhe nga agjencitë qeveritare ose administratat publike që duan të përmirësojnë cilësinë e shërbimeve publike. Përveç kësaj, kjo qasje përdoret gjerësisht edhe nga shoqëria civile dhe studiuesit. Krahas vlerësimit të shërbimeve specifike, kjo qasje mund të përdoret edhe për të pyetur qytetarët për ndarjen e buxhetit, nëse janë të kënaqur me shpërndarjen aktuale të mjeteve buxhetore dhe si do ta shpërndanin ata vetë. Instrumenti i njohur si “Fokusi” është veçanërisht i rëndësishëm për grupet e organizatave joqeveritare dhe për qytetarët që duan të ndikojnë në rialokimin e burimeve duke mbrojtur një masë, politikë ose veprim specifik. Kjo metodë mund të përdoret edhe për të vlerësuar opinionet e përfituesve mbi raportin e të ardhurave publike dhe shpenzimeve publike, mbi opinionin e tyre mbi barrën tatimore, nëse ata do të ishin të gatshëm të paguanin taksa më të larta për të financuar shpenzime më të larta publike, një buxhet apo program të ri me ndjeshmëri ndaj gjinisë. Nga ana tjetër, a ndihen ata se po paguajnë taksa më tepër sesa duhet dhe si rrjedhojë reduktojnë aktivitetet ose kalojnë drejt zonës informale e, ndoshta për këtë arsye, mund të jenë pro uljes së normave tatimore ose rritjes së përfitimeve nga tatimet⁷.

3.4 Analiza e ndikimit të shpenzimeve publike në përdorimin e kohës nga perspektiva gjinore

Analiza nga perspektiva gjinore e ndikimit të shpenzimeve publike në përdorimin e kohës është i ashtuquajti studim i buxhetit nga këndvështrimi i kohës. Ky është instrumenti analitik kryesor i buxhetimit gjinor, me ndihmën e të cilit shihet se si ndikon politika ekzistuese e të ardhurave dhe shpenzimeve publike në buxhetet kohore të burrave dhe të grave. Në të njëjtën kohë, kjo analizë duhet të bëjë të mundur që koha që gratë shpenzojnë për punë të papaguar të merret parasysh në buxhet dhe në analizimin e politikave të ndryshme. Llogaritet se sa varen buxhetet nga puna e papaguar, siç është kujdesi për fëmijët, për të moshuarit, të pafuqishmit dhe të sëmurët, gatimi, mirëmbajtja e shtëpisë dhe punë të tjera të ngjashme. Zbatimi i këtij instrumenti presupozon kryerjen e studimeve mbi buxhetet kohore, të cilat përgjithësisht nuk zhvillohen në nivel kombëtar, por mund të gjenden në formën e rasteve studimore, brenda dhe jashtë sektorit qeveritar. Studimet e përdorimit të kohës tregojnë se gratë shpenzojnë një pjesë të kohës së tyre duke bërë punë të papaguara dhe duke u kujdesur për të tjerët në familje. Duke qenë se këto vende pune nuk vlerësohen nga ana monetare, ato nuk pasqyrohen në modelet makroekonomike, megjithëse kanë rëndësi të madhe ekonomike. Me fjalë të tjera, qëllimi është identifikimi i implikimeve makroekonomike të punës së papaguar në riprodhimin shoqëror. Kjo mund të bëjë që koha që gratë shpenzojnë duke bërë punë të papaguar të vlerësohet në aspektin monetar dhe të futet në llogaritjen e të ardhurave kombëtare bruto si “të ardhura familjare”. Transferimi i çështjeve sociale nga sfera publike në atë private paraqet vetëm një zhvendosje të kostove nga sektori i paguar (sektori publik) në sektorin e papaguar (familje). Kjo ndikon kryesisht në buxhetin kohor të atyre që duhet ta bëjnë këtë punë në sferën private, zakonisht gratë. Të dhënat për një analizë të tillë mund të merren, për shembull, duke llogaritur sasinë e punëve shtesë për një grua, nëse do të hiqeshin disa shërbime shtetërore, ose duke e shprehur në terma monetarë punën e papaguar sipas çmimeve të tregut të vendeve përkatëse të punës.

Pyetjet për të cilat ky mjet ofron përgjigje janë:

Si ndikojnë shpenzimet ndryshe tek përdorimi i kohës nga gratë dhe përdorimi i kohës nga burrat



7 Hadžiahmetović, A., Đurić-Kuzmanović, T., Klatzer, E. & Risteska M. 2013. Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor, UN Women, f. 170.

Për ta përdorur këtë mjet, është e nevojshme të mblidhen informacione se si e përdorin kohën gratë dhe burrat. Burimi i informacionit për kohën e përdorur janë anketat e përdorimit të kohës, të klasifikuara sipas gjinisë dhe variablove të tjerë, si moshë, numri i fëmijëve, shkalla e formimit profesional, madhësia e familjes etj., të mbledhura nga zyrat e statistikave.

Mbetet pyetja se si ndikojnë shpenzimet buxhetore dhe rialokimi i shpenzimeve në buxhetin kohor të grave dhe të burrave. Në këtë kontekst, ekzistojnë disa qasje:

- 1** Llogaritja e "taksës riprodhuese" e përcaktuar si pjesa e vlerës që një person shpenzon për punën riprodhuese të papaguar në mbështetje të shoqërisë. Ndryshimet në llogaritjen e tatimit riprodhues mund të lidhen me ndryshimet në taksat të tjera
- 2** Llogaritja e matricave hyrje-daljeve që përfshin kujdesin e papaguar si hyrje dhe si dalje, si dhe shpenzimet e sektorit social
- 3** Llogaritja e shpenzimit të kohës dhe parave të familjes për shërbime, shëndetësi, arsim, kompjuterë, transport. Ndryshimet në konsumin e kohës mund të lidhen me ndryshimet në shpenzimet publike.

Analiza e ndara sipas gjinisë e ndikimit të shpenzimeve publike në përdorimin e kohës është një mjet i përdorur nga departamentet analitike në administratën publike si dhe nga institucionet kërkimore shkencore që kryejnë analiza të ndikimit të politikave ose buxheteve specifike në përdorimin e kohës dhe në punën e papaguar.

Për shkak të natyrës sasiore të këtij mjeti, organizatat e shoqërisë civile kanë një rol shumë të rëndësishëm në prezantimin e mbledhjes sistematike të të dhënave për përdorimin e kohës përmes sondazheve të përdorimit të kohës, si dhe futjen e llogarive shtesë përmes iniciativave lobuese dhe avokuese. Aktorët e shoqërisë civile mund të kontribuojnë për të tërhequr vëmendjen për rëndësinë e kohës së papaguar përmes studimeve të përdorimit të kohës ose provave pilot mbi vlerësimet e përafërta të vëllimit të punës së papaguar ose implikimet e buxhetimit në rritjen ose rënien e sasisë së punës së papaguar.

Rasti studimor: Projekti i grave shtëpiake si reduktim i punës së papaguar në familje - analizë sasiore dhe cilësore. Paga minimale, paga mesatare, paga mesatare e një burri ose një gruaje ose pagat për aktivitete të ngjashme të lidhura me ekonominë e tregut mund të përdoren si bazë për llogaritjen e vlerës monetare të punës së papaguar.



04

MJETET PËR ANALIZIMIN GJINOR TË TË ARDHURAVE BUXHETORE



4.1 Taksat si çështje të barazisë gjinore

Taksat janë një burim i rëndësishëm i të ardhurave publike. Me të ardhurat publike financohen shpenzimet buxhetore. Shërbimet publike dhe investimet publike janë çelësi i promovimit të barazisë dhe fuqizimit të grave. Politikatat tatimore mund të adresojnë disa nga pabarazitë gjinore kryesore dhe t'i zvogëlojnë/ose t'i rrisin pabarazitë gjinore (p.sh. hendekun gjinor të pagave ose hendekun gjinor sa i përket pronësisë):

- Kontributet në të ardhurat publike bazuar në parimin e aftësisë paguese
- Nga mënyra se si vendosen taksat
- Duke u nisur nga çfarë taksohet dhe sa taksohet (sistemi tatimor)).

Ndikimet e ndryshme në individë të ndryshëm varen nga kush paguan taksa dhe sa taksa paguan, parimi i aftësisë paguese dhe hendeku gjinor në paga/pabarazia e të ardhurave.

Në varësi të mënyrës se si ndikojnë taksat tek ekonomia, taksat ndahen në:

- 1** Taksa direkte (taksa mbi të ardhurat personale, kontributet e sigurimeve shoqërore, tatimi mbi të ardhurat e korporatave, tatimet mbi pasurinë, taksat mbi trashëgiminë, etj.)
- 2** Taksa indirekte (taksa mbi vlerën e shtuar, akciza, detyrimet e importit)
- 3** Tarifat e përdoruesve (tarifat për përdorimin e shërbimeve publike (p.sh., në shëndetësi, arsim, ujësjellës-kanalizime, furnizim me energji elektrike, etj.)
- 4** Të tjera, p.sh. renta minerare nga burimet natyrore.

Kuadri i të Drejtave të Njeriut si detyrime shtetërore funksionon si pjesë e tërësisë së të Drejtave të Njeriut (KEDNG, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore...):

- Ndalon diskriminimin ndaj grave në të gjitha format e tij
- I detyron shtetet ta dënojnë këtë diskriminim dhe të ndërmarrin hapa “me të gjitha mjetet e duhura dhe pa vonesa” për ndjekjen e një politike që çon drejt eliminimit të një diskriminimi të tillë.

Shtatë parimet e kornizës së të drejtave të njeriut:

1. përmbushja e niveleve minimale thelbësore të të drejtave ekonomike dhe sociale,
2. domosdoshmëria e realizimit progresiv,
3. shmangia e bërjes prapa
4. **mosdiskriminimi dhe promovimi i barazisë thelbësore**
5. **përdorimi i burimeve maksimale të disponueshme**
6. domosdoshmëria e pjesëmarrjes, transparencës dhe llogaridhënies
7. respektimi i detyrimeve të tyre ekstrashtetërore



Parimi i mosdiskriminimit dhe barazisë thelbësore. Taksimi individual për garantimin e parimit të mosdiskriminimit. Tatimi mbi të ardhurat e përbashkëta mund të jetë diskriminues (përfiton mesatarisht ai që ka të ardhurat më të larta (shumica burra); partnerja me të ardhura më të ulëta ndoshta paguan më shumë taksë; dekurajon pjesëmarrjen (e grave) në tregun e punës; kurse taksimi veç e veç e përmirëson situatën negociuese të gruas në familje).

Rimbursimi i taksave që shkon tek ai që fiton më shumë para mund të jetë diskriminues. Ai që merr më shumë të ardhura (shumica burra) përfiton, ndërkohë që supozimi se të ardhurat në familje ndahen brendapërbrenda familjes nuk vlen.

Taksimi në mënyrë të barabartë i të ardhurave nga të gjitha burimet për garantimin e mosdiskriminimit. Favorizimi i të ardhurave nga kapitali krahasuar me burimet e tjera të të ardhurave si diskriminues – burrat kanë më shumë të ardhura nga kapitali. Zbritjet dhe përjashtimet nga tatimi mbi të ardhurat. Analiza se kush përfiton – a përfitojnë gratë dhe burrat në mënyrë të barabartë (?), p.sh., zbritjet e taksave për të punësuarit me kohë të plotë, për skemat e fondeve të pensioneve private

4.2 Analiza e incidencës tatimore nga perspektiva gjinore

Për të llogaritur barrën tatimore të grupeve të ndryshme të qytetarëve dhe familjeve të tyre duhet të kemi të dhëna ose përlogaritje të përafërta për të ardhurat dhe shpenzimet e familjes. E mira e analizimit të ndikimit që kanë shpenzimet publike në mënyrën e përdorimit të kohës nga pikëpamja gjinore, si një instrument analitik, është se ndihmon për të vlerësuar barrën e grupeve të ndryshme të popullsisë sa u përket taksave direkte dhe atyre indirekte. Politika tatimore ndikon ndryshe tek gratë dhe ndryshe tek burrat, duke i ngarkuar në mënyrë të pabarabartë dhe duke stimuluar ose duke mos stimuluar mundësi të ndryshme. Duke qenë se gratë fitojnë mesatarisht më pak se burrat, ato zakonisht paguajnë më pak tatime direkte mbi të ardhurat. Në rastin e taksave indirekte (si TVSH-ja, akciza), kjo marrëdhënie mund të ndryshojë lehtësisht në të kundërtën. Burrat dhe gratë konsumojnë produkte dhe shërbime të ndryshme. Gratë marrin më shpesh përgjegjësinë për blerjet e përditshme në familje. Për shembull, modelet e konsumit të familjeve me kryefamiljare gra fokusohen më shumë tek ushqimi dhe shkollimi sesa në familjet me kryefamiljarë burra. Taksat mbi vlerën e shtuar dhe akcizat i ngarkojnë grupet e varfra të popullsisë më shumë se të pasurit, pasi ata shpenzojnë një pjesë relativisht të madhe të të ardhurave të tyre për nevojat e jetës. Hapa të ngjashëm ndërmerren kur vendosen taksat e reja për shërbime publike të pataksuara më parë. Paragjykime gjinore mund të ketë edhe në subvencionet tatimore, lehtësirat tatimore, përjashtimet tatimore dhe kreditimet tatimore që kanë si synim vetëm burrat ose shërbime të tilla nuk ekzistojnë fare për gratë e martuara që nxjerrin vetë të ardhura.

Analiza e incidencës tatimore sipas gjinisë nis nga pyetja:

Si ndikojnë të ardhurat e mbledhura nga qeveria ndryshe tek burrat dhe ndryshe te gratë? Bëhet fjalë si për të ardhurat që mblidhen si përmes taksave direkte (taksat mbi të ardhurat e korporatave) dhe taksave indirekte (taksat mbi vlerën e shtuar)?



INë përgjithësi, taksat janë burimi kryesor i mbledhjes së të ardhurave publike. Prandaj, politika tatimore është në qendër të debatit publik rreth shërbimeve që duhet të ofrojnë qeveritë dhe kush duhet të paguajë për to, duke përfshirë si gratë, ashtu edhe burrat. Megjithatë taksat duken

si asnjëse në aspektin gjinor, ato përmbajnë në vetvete paragjykime gjinore të dukshme dhe të nënkuptuara. Analiza e taksimit nga këndvështrimi gjinor mund t'i nxjerrë në pah këto paragjykime dhe të përbëjë edhe një nxitje për reformë tatimore. Analiza e të ardhurave publike nga këndvështrimi gjinor, pra, analiza e sistemit tatimor me format e ndryshme të taksave dhe vendi relativ që ato zënë në të ardhurat publike, formave të ndryshme të taksave direkte dhe indirekte, si dhe e reformës tatimore mund të nisë nga pika të ndryshme. Bashkë me të ardhurat nga taksat, edhe tarifatat e ndryshme mund të jenë një burim i rëndësishëm i të ardhurave publike.

Analiza e incidencës tatimore të të ardhurave sipas gjinisë merret si me taksat direkte, ashtu edhe me ato indirekte dhe me format e tjera të të ardhurave, si tarifatat lokale, për të llogaritur se sa taksa (ose forma të tjera të ardhurash publike) paguhen nga individë të ndryshëm ose familje të ndryshme. Për të bërë një analizë të incidencës tatimore sipas gjinisë nevojiten të dhëna për të ardhurat dhe shpenzimet. Kjo metodë analizime ka një kufizim, që vjen për shkak se të dhënat zakonisht disponohen vetëm për familjet.

Përveç punës analitike për përcaktimin e incidencës së të ardhurave, mund të zhvillohen edhe një sërë aktivitete të tjera për të pasur një analizë më të mirë gjinore të të ardhurave publike në kontekstin e punës për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor:

- » Mbështetja dhe rritja e përpjekjeve ekzistuese për përmirësimin e mbledhjes së burimeve të ndara sipas gjinisë. Administrata tatimore mund të mbështetet për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë si dhe të dhënave të tjera të nevojshme për hartimin e raporteve mbi analizën e politikës tatimore.
- » Mbështetja e analizës juridike të legjislacionit tatimor për identifikimin e paragjykimeve të shprehura dhe për formulimin e rekomandimeve për ndryshime.
- » Mbështetja e studimeve shkencore për rritjen e barazisë në mënyrë që një pjesë më e madhe e të ardhurave tatimore të kalojë nga taksat indirekte tek taksat direkte më progresive. Këto studime duhet të fokusohen te pasojat e shpërndarjes, si dhe tek aspektet administrative të taksave mbi të ardhurat personale dhe taksat e korporatave, për ato vende ku taksat mbi të ardhurat personale përfaqësojnë tashmë një pjesë të totalit të të ardhurave tatimore, mbrojtësit e buxhetimit gjinor duhet të marrin në konsideratë paragjykimet e mundshme në lidhje me raportimin mbi taksimin mbi të ardhurat individuale dhe të ardhurat e përbashkëta, si dhe paragjykimet në lidhje me strukturën e përjashtimeve, uljeve dhe tarifave.
- » Kryerja e studimeve shkencore mbi paragjykimet gjinore në lidhje me taksat indirekte, TVSH-në, taksat e konsumit ose taksat e shitjes. Analistët që e analizojnë buxhetin nga pikëpamja gjinore duhet të marrin në konsideratë natyrën e përjashtimeve të parashikuara nga TVSH-ja dhe nëse këto përjashtime vlejnë për taksapagues të vegjël, për ushqimet apo për nevojat bazë që kontribuojnë në zhvillimin e kapitalit njerëzor, duke përfshirë edhe shëndetin dhe arsimin.



4.3 Analiza e taksave dhe tarifave të përfituesve nga perspektiva gjinore

Analizimi i taksave/tarifave të përfituesve nga perspektiva gjinore nis nga pyetja:

Si ndikojnë këto taksa dhe tarifa ndryshe te gratë dhe te burrat



Të pasurit e një sistemi të drejtë tatimor është thelbësor për garantimin e barazisë gjinore dhe për adresimin e varfërisë. Një sistem i tillë duhet: të pasqyrojë aftësinë paguese të njerëzve, t'i lejojë qeverisë hapësirën për politika ekonomike dhe sociale, duke përfshirë edhe mbledhjen e parave për financimin e shërbimeve publike cilësore dhe sigurimin social, të nxisë tek njerëzit dhe kompanitë sjellje të dëshirueshme dhe të dekurajojë sjelljet e padëshirueshme, duke kontribuar në mbylljen e hendekut gjinor, p.sh. hendekun në paga. .

Në tabelën vijuese, mund të shohim vendin që zënë taksat e ndryshme në të ardhurat e përgjithshme publike - p.sh. TVSH-ja kundrejt tatimit mbi të ardhurat e personelit të korporatave. Programet e konsolidimit fiskal që nxisin uljen e normave të taksave mbi kapitalin dhe të ardhurat e korporatave, por rrisin taksat mbi konsumin - pjesë e kalimit drejt taksave me impakt gjinor. Taksat më të larta mbi konsumin mund t'i shtojnë gratë më shumë drejt përkujdesjes dhe punëve të papaguara në familje.

Tabela 4: Lëvizjet e të ardhurave nga tatimet në Maqedoninë e Veriut në miliona denarë

	2017	2018	2019	2020	2021
Të ardhurat	181.685	192.130	212.067	198.009	230.744
Taksat	113.770	124.269	126.904	115.672	137.970
Taksat mbi të ardhurat, fitimet dhe fitimet kapitale	26.934	32.834	30.678	29.530	31.678
Taksat mbi pagat dhe fuqinë punëtore	0	0	0	0	0
Taksat mbi pronën	1.298	1.510	1.625	1.476	1.732
Taksat mbi mallrat dhe shërbimet	78.529	82.385	86.506	75.998	93.841
Taksat mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtare	4.942	5.362	5.898	6.669	8.448
Taksa të tjera	2.067	2.179	2.197	1.999	2.270

	2017	2018	2019	2020	2021
Kontributet sociale	46.842	49.719	61.079	66.139	69.741
Grantet	7.313	2.965	3.678	2.546	6.073
Të ardhura të tjera	13.761	15.176	20.405	13.653	16.960

Burimi: Zbërthimi i Detajuar i të Ardhurave - Të dhënat e FMN-së

Taksat indirekte ngarkojnë më shumë grupet me të ardhura më të ulëta:

- Rritja e pagesave të TVSH-së si pjesë e të ardhurave është më e lartë për grupet më vulnerabël (gra kryefamiljare, familje të varfra me 60% të anëtarëve gra dhe vajza)
- Futja e normave zero për nevojat bazë: për të kompensuar peshën më të lartë të barrës tatimore indirekte për të ardhurat e ulëta.

Renditje e taksave për sa i përket “ndikimit negativ” të tyre:

- Taksat mbi pronën (veçanërisht taksat e përsëritura mbi banesën): më pak “të dëmshmet”
- Taksat mbi konsumin – edhe këto më pak të dëmshme
- Taksat mbi të ardhurat personale (duke përfshirë edhe kontributet e sigurimeve shoqërore) janë më të dëmshme.
- Taksat mbi të ardhurat e korporatave > më të dëmshmet

Rast studimor: Analiza gjinore e taksave: Kush përfiton nga ulja e tatimit mbi të ardhurat?

4.4 Kostot e politikave dhe programeve me rëndësi të lartë për gratë dhe vajzat

Llogaritja e kostove të politikave dhe programeve shumë të rëndësishme për gratë dhe vajzat ka për qëllim të vlerësojë se sa shpenzime publike nevojiten për të ofruar shërbime të caktuara ose për të zbatuar politika të caktuara.

Përveç koston monetare, këtu mund të përfshihen edhe kosto të tjera, si për shembull kostoja e kohës së punës së papaguar për përfituesit e programeve të caktuara. Për të parë se çfarë i kushton qeverisë nëse nuk ndërmer asnjë veprim, mund të përdoren mjete që shërbejnë për matjen e kostove, siç është për shembull vënia në dukje e kostove të dhunës në familje.

Ky mjet nënkupton një qasje cilësore. Është pak a shumë i ngjashëm me aspektet teknike të analizës së incidencës së shpenzimeve publike. Ndërkohë që analiza e incidencës së shpenzimeve publike është një instrument analitik që përdoret ex post, pra pasi është zbatuar një shërbim specifik dhe kur i kemi të dhënat për kostot faktike dhe përdoruesit e shërbimit,

përcaktimi i kostos bëhet ex ante, pra paraprakisht. Kostimi i politikave dhe programeve bëhet për të përllogaritur kostot e zbatimit të aktiviteteve të planifikuara ose të dëshiruara.

Për të zbatuar teknikat e kostimit, ajo që na duhet është informacioni mbi kostot e inputeve (punonjësit, materialet, furnizimet) për shërbimet që do të ofrohen (kostot e një njësie specifike shërbimi) dhe një përllogaritje e masës së përdorimit të atij shërbimi (numri i rasteve ose numri i pjesëmarrësve). Kostoja totale llogaritet duke shumëzuar koston për njësi të inputit me numrin e njësive të siguruar.

Si qasje sasiore, ajo mund të përdoret në agjencitë qeveritare dhe në administratën publike, por mund të përdoret kryesisht edhe nga aktorë që zotërojnë aftësi të përshtatshme për studime shkencore. Dobia e këtij mjeti varet kryesisht nga disponueshmëria e informacionit për arritjen e përllogaritjes sa më të saktë të të dhënave.⁸

8 Hadžiahmetović, A., Đurić-Kuzmanović, T., Klatzer, E. & Risteska M. 2013. Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjnjor, UN Women, f. 177.



05

LISTA E VERIFIKIMIT



Buxheti përbëhet nga para publike që duhet të përdoren për interesin publik dhe duke qenë se shteti i mbledh dhe i shpërndan fondet përmes buxhetit dhe përcakton prioritetet e financimit, në procedurën e hartimit të buxhetit duhet të marrë pjesë edhe publiku (përveç Kuvendit, Qeverisë, Ministrisë së Financave dhe përfituesve të fondeve buxhetore), veçanërisht gratë, të cilat në rastin tonë nuk i kanë shfrytëzuar të gjitha mundësitë (median, institucionet shkencore, OJF-të, grupet e interesit) për të marrë pjesë në diskutimet për hartimin dhe për shpërndarjen e buxhetit.

Në varësi të informacioneve që mund të ekzistojnë në lidhje me politikën dhe buxhetin që analizohet, mund të bëhen vlerësime të ndryshme. Për qëllime empirike, më së shpeshti përdoret qasja me pesë hapa, e cila tregon një kurs të qartë veprimi gjatë zbatimit të një politike, programi dhe vlerësimi sektorial me ndjeshmëri gjinore.

hapi 1

Hapi i parë analizon pozicionin e grave dhe të burrave, të vajzave dhe të djemve (dhe nëngrupeve të ndryshme) në sektorë të ndryshëm (për shembull në sektorin e arsimit). Nëse është e mundur, situata mund të paraqitet në mënyrë statistikore.

hapi 2

Hapi i dytë përcakton nëse politika është apo jo e ndjeshme ndaj aspektit gjinor. Për shembull, a përputhet me situatën e përshkruar në hapin e parë? Kontrollon nëse me zbatimin e kësaj politike hendeku gjinor do të jetë më i madh, më i vogël apo do të mbetet njësoj.

hapi 3

Hapi i tretë vlerëson se sa i përshtatet ndarja e buxhetit zbatimit të politikës me ndjeshmëri gjinore. Përcaktohet nëse politika është vetëm një dokument në letër ("pa dhëmbë").

hapi 4

Hapi i katërt kontrollon nëse shpenzimet janë bërë realisht ashtu siç ishin planifikuar

hapi 5

Hapi i pestë vlerëson rezultatet afatgjata ose shqyrton se si ka ndikuar politika në fjalë në shpenzimin e fondeve. Për shembull, vlerësohet nëse ajo politikë ka nxitur barazinë gjinore dhe nëse përpiqet të sjellë ndryshime.

Tre hapat e parë të kësaj qasjeje mund të zbatohen duke u bazuar tek dokumentacioni buxhetor. Nëse qeveria nuk raporton saktë ose nuk e mbledh informacionin e duhur, për hapat e mëtejshëm nevojitet edhe punë në terren.

Analiza gjinore e buxhetit është një mjet shumë i rëndësishëm që mund të garantojë që burimet t'u caktohen atyre faktorëve që kontribuojnë në promovimin e barazisë gjinore mes burrave dhe grave dhe në zhvillimin e shoqërisë në përgjithësi. Hartimi i një buxheti gjinor dhe kryerja e një analize gjinore të buxhetit është një punë komplekse në ekip që kërkon angazhimin dhe bashkëpunimin e ngushtë të të gjithë aktorëve socialë. Po kështu, edhe përfitimet e buxhetimit gjinor janë të shumëfishta.

Analizat buxhetore me ndjeshmëri gjinore janë një nga mënyrat efikase që qeveritë mund të përdorin për përmbushjen e angazhimeve të tyre gjinore, si dhe për zbatimin e rekomandimeve

dhe planeve të veprimit të aktorëve ndërkombëtarë, si dhe për të demonstruar arritjen e progresit në promovimin e barazisë gjinore duke e përqendruar vëmendjen te shpenzimet publike. Prandaj, BPGJ-ja parandalon humbjet kombëtare që mund të lindin nga mosmarrja në konsideratë e ndikimeve gjinore të të ardhurave dhe shpenzimeve publike, i ofron qeverisë mundësinë për të arritjen e një zhvillimi më të balancuar dhe më të qëndrueshëm dhe mund të jetë një instrument i barazisë gjinore, llogaridhënies, transparencës, efikasitetit, efikasitetit dhe administrimit të mirë të të ardhurave tatimore.

Përfitimet që sjell BPGJ-ja për gratë dhe për OSHC-të lidhen me njohjen, adresimin dhe rivlerësimin e kontributeve të padukshme dhe të pavlerësuar sa duhet që japin gratë në sferat private, riprodhuese të ekonomisë dhe kujdesit familjar. Prandaj, BPGJ-ja mundëson afirmimin e rolit të gruas në sferën publike dhe private të politikës, ekonomisë dhe shoqërisë (si dhe në parlament, biznes, media, kulturë, organizata fetare, sindikata dhe institucione të shoqërisë civile) dhe të nevojave të anëtarëve të marxhinalizuar të shoqërinë duke ndërtuar një koalicion të organizatave të grave gjatë punës për BPGJ-në.

REFERENCA

- Buxheti i Bashkisë së Novi Sadit për vitet 2018, 2019 dhe 2020.
- [Buxheti për t'i dhënë fund pabarazive gjinore në sektorin e arsimit | Konsorciumi për Barazinë Gjinore, për Siguri dhe për të Drejtat e Njeriut \(genderandsecurity.org\)](#)
- Këshilli i Evropës. 2005. Raporti përfundimtar i Grupit të Specialistëve për Buxhetimin Gjinor (EG-S-GB), EG-S-GB (2004) RAP FIN; Divizioni për Barazinë, Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut, Këshilli i Evropës, Strasburg, (gjendet në http://www.mpsv.cz/files/clanky/12462/GenderBudgeting-report2005_En.pdf)
- Downes, R., von Trapp, L. & Nikol S. 2017. Buxheti gjinor në vendet e OBZHE-së, Revista e OBZHE-së për Buxhetin, Vëllimi 2016/3 ([Buxheti gjinor-in-OECD-countries.pdf](#))
- Elborgh-Woytek, K. Newiak, M., Kochhar, K., Fabrizio, S., Kpodar, K., Wingender Ph., Clements, B. & Schwartz G. 2013. 'Gratë, puna dhe ekonomia: përfitimet makroekonomike nga barazia gjinore', nga diskutimet e stafit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, SDN/13/10 (<http://www.imf.org/external/pubs/ft/sdn/2013/sdn1310>)
- Instituti Evropian për Barazi Gjinore. Integrimi gjinor: Buxheti gjinor 2019.
- Integrimi gjinor: Një strategji globale për arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave dhe vajzave. UN Women, gjendet në: <https://www.unwomen.org/sites/default/files/Headquarters/Attachments/Sections/Library/Publications/2020/Gender-mainstreaming-Strategy-for-achieving-gender-equality-and-emp>
- Hadžiahmetović, A., Đurić-Kuzmanović, T., Klatzer, E. & Risteska M. 2013. Buxheti i Përgjeshëm Gjinor, UN Women, f. 177.
- <http://www.financa.gov.al/programi-buxhetor-afatmesem-2020-2022-faza-iii/>
- Stotsky, J. 2016. 'Buxheti gjinor: konteksti fiskal dhe rezultatet aktuale', dokument pune i Fondit Monetar Ndërkombëtar, WP/16/149, Washington DC.
- Raport pune, f. 18-24, [ZVEŠTAJ O RADU NSZ ZA 2021.pdf](#)

